

FJALA E DEPUTETIT TONI GOGU

E ENJTE 7 TETOR 2021

E nderuar zonja Kryetare,

Të nderuar kolegë deputetë,

Sot qeveria shqiptare na ka përballur me nevojën urgjente të së tashmes. Këshilli i Ministrave ka zgjedhur të ushtrojë të drejtën kushtetuese për të nxjerrë aktin rregullator me fuqinë e ligjit dhe të dakordësojë edhe 500 mijë vaksina të tjera Pfizer. Edhe në garën midis virusit dhe vaksinës, koha është gjyqtari më i rreptë. Nëse i mallkuari mbërrin edhe një sekondë më parë, një jetë shuhet. Togfjalëshi më i dëshpëruar “erdhët shumë vonë” do të ushtojë përjetësisht në veshët e familjeve, të afërmeve, miqve, mjekëve, shoqërisë, të gjithëve ne, ndaj qeveria ka vendosur përsëri të mos hallakatet dhe të shpengojë kohën, duke vënë në lëvizje instrumentin kushtetues të aktit normativ me fuqinë e ligjit. E theksoj fjalën “përsëri”, pasi akti i parë normativ është miratuar më 18 janar të këtij viti dhe mban numrin 3. Ky është fakti i parë që dua të paraqes sot për t’u kujtuar të gjithë bashkëqytetarëve se plani i vaksinimit për t’u rikthyer atyre buzëqeshjen ka nisur me fillimin e vitit dhe nuk ka ndalur së zbatuari asnjë çast. 2 074 560 doza vaksinash nuk janë “lugë bosh në 3D”, siç do të shpreheshin kolegët e opozitës, por doza të sigurt, efikase dhe falas, që kanë kaluar aeroportin e “Rinasit” dhe u janë administruar mjekëve dhe infermierëve, policëve dhe edukatorëve, prindërve dhe të afërmeve tanë në çdo qendër shëndetësore, në çdo qendër vaksinimi të përqendruar dhe në çdo qendër vaksinimi të lëvizshme. Të nderuar kolegë, nuk do shumë mend të kuptosh se lufta me këtë armik të padukshëm nuk ka përfunduar ende.

Variacionet e shumta të Sars COVID-19 kanë rritur numrin e të infektuarve, por dëshmitë na tregojnë qartë se të vaksinuarit shumë rrallë hyjnë në shtigje të ngatërruara të shërimit, ndërkohë që të pavaksinuarit jo rrallë e humbin betejën e jetës me të. Pothuajse 1 milion shqiptarë kanë bërë zgjedhjen e duhur duke u vaksinuar me dozën e parë dhe pothuajse 800 mijë janë vaksinuar me të dyja dozat, ndërkohë janë edhe mbi 1 milion bashkëqytetarë që nevojitet të vaksinohen. Ndaj qeveria nuk ka humbur kohë. Ndaj qeveria e ka konsideruar të nevojshme dhe urgjente rritjen e sasisë së dozave të vaksinës. Ndaj edhe ne nuk duhet të humbim asnjë sekondë kohë, me dyshime se vaksinat janë “të skaduar” apo se Bashkimi Europian “nuk njeh” certifikatën tonë të vaksinimit, e kesi gjepurash. Testet, vaksinat, infermierët, mjekët dhe epidemiologët, qendrat shëndetësore, spitalet Covid dhe spitalet rajonale, aparaturat dhe protokollat përkatëse janë mjete konkrete që sistemi ynë shëndetësor ka në dispozicion. Këto mjete janë të dukshme për këdo që ka sy të shohë dhe të prekshme për të gjithë ata kolegë që kanë guximin dhe dhembshurinë ta vënë një dorë në shërimin e kësaj flame.

Ndaj sot si ligjvënës të përgjegjshëm, duhet të nxitojmë të miratojmë aktin normativ. Ndërkohë, duhet të ndërgjegjësojmë përmes shembullit tonë të gjithë ata bashkëqytetarë që ende po hezitojnë të vaksinohen dhe se në këtë moment nevojë dhe urgjence, ne mund t’ia dalim mbanë vetëm me besimin te faktet, tek e vërteta shkencore dhe te bashkëpunimi me njëri-tjetrin. Përndryshe, nëse zgjedhim të yshtemi me përralla konspirative apo të hallakatemi në kthinat e pasigurisë, të jemi të sigurt, se në librin e padukshëm të jetës do regjistrohemi si ata që shpërdoruan kohën dhe mbërritën shumë vonë. Faleminderit!